

## **In memoriam**

### **VDIQ ANËTARI I KOMISIONIT QENDROR XHELIL PAJAZITI**

8.02.2010



Më 7.02. 2010, ndërroi jetë anëtari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ( përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës në KQZ ), Xhelil Pajaziti. Xhelil Pajaziti, lindi në fshatin Poliçkë të komunës së Kamenicës ( Dardanë), më 19 janar të vitit 1941. I takon gjeneratës së parë të normalistëve të Kosovës (mësues i kualifikuar). Vite më vonë, Xhelil Pajaziti ka studiuar Fakultetin Juridik dhe, ka diplomuar në vitin 1979. Deri në vitin 1980, ka punuar në fushën e arsimit. Në këtë kohë, largohet nga procesi mësimorë si i apërshtatshëm ideo-politikisht dhe, caktohet të punojë në Ndërmarrjen Bujqësore të ish-Kamenicës ( Dardanë).

Pas mbarimit të luftës më 1999, në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (QPK), ka udhëhequr Drejtoratin për Administratë në Gjilan dhe në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Në zgjedhjet e para lokale të mbajtura në vitin 2000, ishte anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, ishte anëtar i GZAP-it, i caktuar nga Ambasadori i OSBE-së. Nga viti 2002 deri më 5 janar të vitit 2005, ishte Këshilltar Ligjor i Ministrit të Shërbimeve Publike, z. Jakup Krasniqi.

Xhelil Pajaziti është veprimtar i hershëm politik: para viteve të 90-ta dhe, edhe pas vitit 1999. Ka qenë bashkëpunëtor i gazetës ilegale “Zëri i Kosovës”, që është botuar në Perëndim nga Lëvizja për Republikën e Kosovës. Ka shkruar artikuj të shumtë lidhur me gjendjen politike dhe kombëtare të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi. Pas luftës, poashtu ka shkruar nëpër gazetën e përditshme artikuj të shumtë lidhur me proceset e rëndësishme në Kosovë. Që nga viti 2004, është anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor. Vdekja e gjeti në detyrën e Këshilltarit Ligjor të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Kosovës dhe të anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.